



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____ / 2016

PËR

DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995, “KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të shkronjës “d”, të pikës 2, të nenit 81 dhe 83, pikës 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 30, pas pikës 10, shtohet pika 11, me këtë përmbajtje:
“11. Shpërblimi i dëmit të shkaktuar.”

Neni 2

Pas nenit 43/a, shtohet neni 43/b, me këtë përmbajtje:

“Neni 43/b

Shpërblimi i dëmit të shkaktuar

Shpërblimi i dëmit të shkaktuar konsiston në pagimin në favor të të dëmtuarit nga vepra penale e një shume të hollash brenda kufijve të parashikuar në ligj.

Gjykata cakton masën e shpërblimit pasi ka bërë vlerësimin e dëmit të ardhur.

Gjykata, duke marrë parasysh gjendjen ekonomike të të dënuarit, mund të lejojë që shpërblimi i dëmit të shkaktuar të paguhet me këste, duke caktuar këstet dhe afatin e pagimit të tyre.”

Neni 3

Paragrafi i tretë, i nenit 46, ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“Masa edukuese janë:

1. Vendosja e të miturit në një institucion edukimi;
 2. Kërkimi i ndjesës ndaj viktimës;
 3. Riparimi ose kompensimi i dëmit të shkaktuar nga vepra penale ose pagesa e gjobës, sipas aftësive, të ardhurave dhe sendeve pasurore të tij;
 4. Përfshirja në punën e organizatave jofitimprurëse ose në aktivitetet që kanë lidhje me komunitetin ose mjedisin;
 5. Ndalimi për të shkuar në vende të caktuara ose aktivitete argëtimi ose qëndrimi larg personave të caktuar të cilët kanë efekt të dëmshëm ndaj tij;
 6. Nënshtrimi ndaj një trajtimi profesional mjekësor, trajtimi për varësinë nga droga ose varësi të tjera me pëlqimin paraprak të përfaqësuesit ligjor të të miturit;
 7. Moslargimi për një periudhë të gjatë kohe nga vendbanimi ose vendqëndrimi i tij i zakonshëm, pa aprovimin e veçantë të marrë nga Shërbimi i Provës.
- Kohëzgjatja e masës edukuese caktohet nga gjykata rast pas rasti.”

Neni 4

Neni 51 ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“Neni 51

Dënimi me burgim për të miturit

Për të miturit, që në kohën e kryerjes së veprës penale nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç, dënimi me burgim jepet vetëm nëse çmohet nga gjykata se dënimet e tjera janë të papërshtatshme. Në çdo rast, dënimi me burgim nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikon ligji për veprën penale të kryer.”

Neni 5

Në nenin 53/a, pas paragrafit të parë, shtohet paragrafi me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“Të gjithë ato persona që janë dënuar me burgim deri në 3 vjet apo që u kanë mbetur pa vuajtur edhe 3 vjet burgim, mund të kërkojnë ta zëvendësojnë dënimin e mbetur me pagimin e një shume të hollash në favor të shtetit, duke llogaritur 5000 lekë për një ditë burgim. Në këtë rast, dënimi konsiderohet i shlyer.”

Neni 6

Neni 57 ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“Neni 57

Llogaritja e paraburgimit

Koha e paraburgimit llogaritet në dënimin me burgim, gjobë ose punë në interes publik si më poshtë:

Një ditë paraburgim e barabartë me 1.5 ditë burgim.

Një ditë arrest shtëpie e barabartë me një ditë burgim.

Një ditë paraburgim e barabartë me 3000 lekë gjobë

Një ditë burgim e barabartë me 2000 lekë gjobë.

Një ditë paraburgim e barabartë me 18 orë pune në interes publik.”

Neni 7

Në nenin 60, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pika 12, e paragrafit të parë, ndryshohet si më poshtë:

“12. T’i nënshtrohet një trajtimi, programi mjekësor ose rehabilitimi me qëllim që të ndalohet përdorimi i alkoolit ose lëndëve narkotike.”

b) Në fund të paragrafit 2, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Detyrimi i caktuar në pikën 11 dhe 12, të paragrafit të parë, të këtij neni, caktohet vetëm me pëlqimin e të dënuarit”.

c) Pas paragrafit 2, shtohet paragrafi 3, me përmbajtje si më poshtë:

“Periudha për përmbushjen e një detyrimi të referuar në paragrafin 1, të këtij neni, përcaktohet nga gjykata brenda periudhës së vlerësuar të provës”.

Neni 8

Në nenin 65/a, bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i parë riformulohet me këtë përmbajtje:

“Gjykata, në dhënien e vendimit, shprehet nëse i dënuari gëzon të drejtën e lirimit me kusht, apo jo, si dhe mund të vendosë edhe caktimin e një periudhe sigurie, gjatë së cilës nuk lejohet zbatimi i nenit 64, të këtij Kodi, në rastet kur ekziston një nga këto rrethana:”

b) Paragrafi i fundit riformulohet me këtë përmbajtje:

“Periudha e sigurisë nuk kalon tre të katërtat e dënimit me burgim, ndërsa në rastin e burgimit të përjetshëm, nuk kalon 30 vjet.”

Neni 9

Në nenin 66, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Shkronjat “a)” dhe “b)”, ndryshohen me këtë përmbajtje:

“a) tridhjetë vjet në rastin e krimeve që parashikojnë dënim me burgim të përjetshëm dhe njëzet vjet për krimet, të cilat parashikojnë dënim me mbi dhjetë vjet burgim;

b) dhjetë vjet për krimet që parashikojnë dënim deri në dhjetë vjet burgim;”

b) Pas paragrafit të parë, shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:

“Veprat penale të Kreut II, Seksionit I, Nenet 76 – 79/c, nuk nënshtrohen parashkrimit”.

Neni 10

Në fund të nenit 69, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Dispozitat e këtij neni zbatohen në çdo rast. Për subjektet që nënshtrohen legjislacionit në fuqi për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, Ministria e Drejtësisë lëshon përmes Zyrës së Gjendjes Gjyqësore, dokumentin zyrtar të vërtetimit të historikut të gjendjes gjyqësore të subjektit.”

Neni 11

Neni 96 riformulohet me këtë përmbajtje:

“Neni 96

Shkelja e etikës mjekësore dhe trajtimi mjekësor alternativ

Veprimi apo mosveprimi i mjekut në kundërshtim me kërkesat e kodit të etikës profesionale, duke shkaktuar dëmtim të konsiderueshëm të shëndetit të pacientit, dënohet me gjobë, heqje të së drejtës së ushtrimit të profesionit dhe me shpërblimin e dëmit të shkaktuar pacientit.

Veprimi apo mosveprimi i punonjësve të tjerë mjekësorë, të cilët gjatë kryerjes së detyrave kanë vepruar në kundërshtim me kërkesat e kodit të etikës profesionale, duke shkaktuar dëmtim të konsiderueshëm të shëndetit të pacientit, dënohet me gjobë, heqje të së drejtës së ushtrimit të profesionit dhe me shpërblimin e dëmit të shkaktuar pacientit.

Ushtrimi i mjekësisë alternative, pa autorizimin përkatës të autoriteteve shëndetësore, kur i ka shkaktuar një dëmtim të konsiderueshëm shëndetit të pacientit, dënohet me gjobë, heqje të së drejtës së ushtrimit të profesionit dhe me shpërblimin e dëmit të shkaktuar.

Po kjo vepër, kur ka shkaktuar vdekjen e pacientit, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.”

Neni 12

Pas nenit 96, shtohen nenet 96/a, 96/b, 96/c, 96/ç, 96/d, 96/dh, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“Neni 96/a

Përhapja e sëmundjeve ngjitëse

Moszbatimi i rregullave të autoriteteve shtetërore për një kontroll mjekësor, dezinfektim, karantinë ose masa të tjera për ndalimin apo parandalimin e sëmundjeve ngjitëse të qenieve njerëzore, kur ka shkaktuar përhapjen e një sëmundjeje ngjitëse, dënohet me gjobë.

Mos zbatimi i rregullave ose urdhrave të autoriteteve shtetërore për marrjen e masave për shtypjen ose parandalimin e sëmundjeve ngjitëse në kafshë, kur ka shkaktuar përhapjen e një sëmundjeje ngjitëse te qeniet njerëzore, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Po kjo vepër, kur ka shkaktuar vdekjen e një apo më shumë personave, dënohet me burgim deri në tetë vjet.

Neni 96/b

Dështimi për dhënien e ndihmës mjekësore

Mosdhënia e ndihmës së parë nga mjeku apo ndonjë punonjës tjetër mjekësor, në shkelje të detyrave të tyre profesionale, dënohet me gjobë ose burgim deri në një vit.

Neni 96/c

Mashtrimi në trajtimin mjekësor

Kryerja e trajtimit mjekësor ose trajtimit alternativ mjekësor, nga mjeku që nuk ka kualifikimet e duhura, duke shkaktuar vonesë në marrjen e ndihmës mjekësore në kohën e duhur për pacientin, dënohet me heqje të së drejtës së ushtrimit të profesionit dhe me shpërblimin e dëmit të shkaktuar.

Po kjo vepër, kur ka shkaktuar dëm serioz për shëndetin e personit, dënohet me gjobë, heqje të së drejtës së ushtrimit të profesionit dhe me shpërblimin e dëmit të shkaktuar.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen, dënohet me burg nga dy deri në tetë vjet.

Neni 96/ç

Transplant i Paligjshëm i Pjesëve të Trupit të Njeriut dhe Modifikimi i Gjeneve/Gjenetik të Njeriut

Një mjek i cili, në mospërputhje me kodin e sjelljes profesionale, heq një pjesë trupi të njeriut ose transplanton një pjesë të trupit të pacientit, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet, me heqje të së drejtës së ushtrimit të profesionit dhe me shpërblimin e dëmit të shkaktuar.

Një mjek i cili me qëllim për të kryer një transplant heq një pjesë nga trupi i njeriut para vdekjes, dënohet në të njëjtën masë.

Dënimi i parashikuar në paragrafin e parë zbatohet dhe për mjekun, i cili në mënyrë të paligjshme heq qelizat embrionale, i trajton ato në mënyrë të ndaluar, ose shkel anonimitetin e dhuruesve të embrionit qelizor.

Një mjek që, me qëllimin për të kryer një transplant i heq një pjesë nga trupi një pacienti ose që transplanton një pjesë të trupit të një pacienti pa marrë pëlqimin paraprak nga dhuruesi ose pranuesi i pjesës së trupit të tyre ose nga përfaqësuesit ligjorë, ose kur, në kundërshtim me procedurat e përcaktuara, magazinon/ruan apo përdor pjesën e hequr të trupit të njeriut për ndonjë qëllim tjetër, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet, me heqje të së drejtës së ushtrimit të profesionit dhe me shpërblimin e dëmit të shkaktuar.

Çdo person i cili përpiket për të kryer ose kryen procedurën, qëllimi i së cilës është që të modifikojë gjenet njerëzore dhe e cila nuk është kryer për qëllime parandaluese, diagnostikuese, ose terapeutike, ose me qëllim/synim për të bërë ndryshime në gjenet e brezave të ardhshëm, dënohet me burgim deri në pesë vjet.

Çdo person që heq ose siguron një pjesë të hequr të trupit të njeriut, për të cilat dhuruesi pranon pagesën, i cili zotëron pjesën e hequr të trupit të njeriut në mënyrë të paligjshme, i cili e përdor ose përpiket për të përdorur trupin e njeriut ose pjesë të tij me qëllim për të fituar përfitime pronësie, ose që në mënyrë të pajustificueshme si dhe për përfitime monetare shërben si një agjent për sigurimin e transplanteve të pjesëve të trupit të një personi të gjallë ose të vdekur, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Neni 96/d

Performancë e pakujdesshme e aktivitetit farmakologjik

Përgatitja ose tregtimi i barnave që nuk kanë në përbërje sasinë e kërkuar të një ilaçi, sipas standardeve të përcaktuara, ose lëshimi i një ilaçi apo substance tjetër nga ajo e përshkruar, dënohet me gjobë dhe heqjen e së drejtës së ushtrimit të profesionit.

Po kjo veprë, kur ka shkaktuar dëmtim të konsiderueshëm të shëndetit të një personi, dënohet me burg deri në gjashtë muaj, heqje të së drejtës së ushtrimit të profesionit dhe me shpërblimin e dëmit të shkaktuar.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen, dënohet me burg nga dy deri në tetë vjet.

Neni 96/dh

Prodhimi dhe tregtimi i ilaçeve të dëmshme

Prodhimi, shitja ose furnizimi me ilaçe apo mjete të tjera mjekësore të rrezikshme për shëndetin dënohet me gjobë dhe me shpërblimin e dëmit të shkaktuar në të gjithë zinxhirin e konsumatorëve.

Angazhimi në nxjerrjen, përgatitjen ose asgjësimin e gjakut të infektuar ose indeve ose qelizave, dënohet me gjobë dhe me heqjen e së drejtës së ushtrimit të profesionit.

Këto vepra, kur kanë shkaktuar dëmtime të rënda ose shumë të rënda trupore ose dëmtime të shëndetit, dënohen me burgim deri në tre vjet dhe me shpërblimin e dëmit.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e një ose më shumë personave, dënohet me burgim nga një deri në dhjetë vjet.”

Neni 13

Paragrafi i parë, i nenit 130/a, ndryshohet me përmbajtje si më poshtë vijon:

“Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, kur kryhet për herë të parë, dënohet me burgim deri në 2 vjet. Në këtë rast, ndjekja penale bëhet mbi ankimin e të dëmtuarit dhe pushon kur ai heq dorë. Kur kjo vepër kryhet në mënyrë të përsëritur, dënohet me burgim deri në 3 vjet. Në këtë rast, ndjekja penale fillon mbi ankimin e të dëmtuarit dhe nuk pushon nëse hiqet dorë nga ankimi.”

Neni 14

Pas nenit 199/b, shtohet neni 199/c, me këtë përmbajtje:

“Neni 199/c

Mungesa e sinjalistikës në kantier

Mungesa e sinjalistikës në kantier gjatë kryerjes së punimeve publike apo private, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, për mbrojtjen dhe sigurinë e shëndetit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë dhe me heqje të licencës së personit përgjegjës apo personit juridik që ka marrë përsipër realizimin e punimeve.

Në rastin e punimeve publike, nëse nga rrethanat nuk del qartë subjekti përgjegjës, përgjegjësia është e autoritetit publik mbikëqyrës të punimeve. Në këtë rast, personi përgjegjës për lidhjen e kontratës dënohet me gjobë ose burg deri në gjashtë muaj dhe me detyrimin për shpërblimin e dëmit.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e një ose më shumë personave, dënohet me burgim nga një deri në shtatë vjet.”

Neni 15

Neni 283 riformulohet me këtë përmbajtje:

“Neni 283

Prodhimi dhe shitja e narkotikëve

Mbajtja, shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi i substancave narkotike, psikotrope, ose i farërave të bimëve narkotike, si dhe mbajtja në një sasi më të madhe se ajo që me ligj konsiderohet për konsum vetjak, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, në varësi të llojit dhe sasisë së lëndëve narkotike të mësipërme, dënohet si më poshtë:

a) Kur lënda narkotike është e llojit “*cannabis sativa*” dhe farërave të kësaj bime dhe sasia e lëndës narkotike është deri në 100 gram, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

b) Kur lënda narkotike është e llojit “*cannabis sativa*” si dhe farërave të kësaj bime dhe sasia e lëndës narkotike është mbi 100 gram deri në 1 kg, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet.

c) Kur lënda narkotike është e llojit “*cannabis sativa*” dhe farërave të kësaj bime dhe sasia e lëndës narkotike është mbi 1 kg deri në 10 kg, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

d) Kur lënda narkotike është e llojit “*cannabis sativa*” dhe farërave të kësaj bime dhe sasia e lëndës narkotike është mbi 10 kg, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

Kur vepra e mësipërme kryhet në bashkëpunim, ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga katër deri në dymbëdhjetë vjet.

Kur vepra e mësipërme kryhet në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur lënda narkotike është e llojit “*heroinë*” apo “*kokainë*”, apo çdo lloj lënde narkotike e ndryshme nga “*cannabis sativa*” dhe farërave të kësaj bime, dhe sasia është deri në 1 kg, dënimi me burgim në minimum shtohet me 1 vit dhe në maksimum me 3 vjet.

Organizimi, drejtimi apo financimi i kësaj veprimtarie, dënohen me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.”

Neni 16

Pas nenit 283, shtohet neni 283/1, me këtë përmbajtje:

Neni 283/ 1

“Prodhimi, mbajtja dhe shitja e narkotikëve në sasi të mëdha”

Mbajtja, shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi apo dorëzimi i lëndëve narkotike “*cannabis sativa*” dhe farërave të kësaj bime, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, në sasi të mëdha mbi 50 kg, dënohet me burgim nga pesë deri në dymbëdhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur lënda narkotike është e llojit “*heroinë*” apo “*kokainë*”, apo çdo lloj lëndë narkotike apo psikotrope e ndryshme nga “*cannabis sativa*” dhe farërave të kësaj bime, dhe sasia është mbi 1 kg, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Neni 17

Neni 283/a riformulohet me këtë përmbajtje:

“Neni 283/a Trafikimi i lëndëve narkotike

Importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi i substancave narkotike ose psikotrope, si dhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, në varësi të llojit dhe sasisë së lëndës narkotike, dënohet si më poshtë:

a) Kur lënda është e llojit “*cannabis sativa*” apo “*farëra të kësaj bime*” dhe sasia është deri në 10 kg, dënohet me burgim nga dy deri në shtatë vjet.

b) Kur lënda është e llojit “*cannabis sativa*” apo “*farëra të kësaj bime*” dhe sasia është mbi 10 kg deri në 50 kg, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

c) Kur lënda është e llojit “*cannabis sativa*” apo “*farëra të kësaj bime*” dhe sasia është mbi 50 kg, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

d) Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

e) Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

f) Kur lënda narkotike është e llojit “*heroinë*” apo “*kokainë*” apo “*çdo lloj lëndë tjetër psikotrope*” dhe sasia është deri në 100 gram, dënohet me burgim nga 3-10 vjet.

g) Kur lënda narkotike është e llojit “*heroinë*” apo “*kokainë*” apo “*çdo lloj lëndë tjetër psikotrope*” dhe sasia është mbi 100 gram deri në 1 kg, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

h) Kur lënda narkotike është e llojit “*heroinë*” apo “*kokainë*” apo “*çdo lloj lëndë tjetër psikotrope*” dhe sasia është mbi 1 kg, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

i) Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

j) Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim dhe më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë deri në njëzet vjet burgim.

k) Organizimi, drejtimi ose financimi i kësaj veprimtarie dënohen me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet. ”

Neni 18
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

ILIR META

DRAFTING